



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 17.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, bënë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Njftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve lokale që të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre për plotësimin e përbërjes së Komisioneve që do të ngritën në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe atë;

- **Komisioni ad-hoc vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - LOKALET AFARISTE ME SIPËRFAQE 50 m² dhe 55 m² të cilët gjendet në njësin kadastrale: P-71712062-00459-0, Tokë urbane në qytet në ZK:Podujevë**
- **TOKË BUJQËSORE ME SIPËRFAQE 44773 m², me numër kadastrale P-71712029-00202-1 ne ZK: LUPÇ I POSHTËM**
- **TOKË BUJQËSORE ME SIPËRFAQE 38882m², me numër kadastrale P-71712029-00209-0 ne ZK: LUPÇ I POSHTËM**
- **TOKË BUJQËSORE ME SIPËRFAQE 23403 m², me numër kadastrale P-71712029-00495-4 ne ZK: LUPÇ I POSHTËM**

Në kuadër të Komisioneve në fjalë do të përfshihet nga një anëtar i sektorit jo qeveritar lokal.

Personat e nominuar për Komisionet e cekura, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këto Komisione, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet me votim në Kuvendin e Komunës.

Afati për aplikim është nga data **20.06.2023 deri më 28.06.2023**, brenda orarit zyrtar të punës, dhe të njëjtat bëhen përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Propozimet gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike zyrtare, në emailin; DPKGJ.podujeva@rks-gov.net

Nr.prot.08-334/07-0041469/23
Podujevë.20.06.2023

